

DITARI MUJOR PRILL 2026



TRASHËGIMIA KULTURORE NË JUG DREJT RIJETËZIMIT DHE PROMOVIMIT TURISTIK

Në jug të vendit po avancon edhe puna për mbrojtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore, ku Manastiri i Kryeengjëjve në Dervican është shpallur Monument Kulture dhe pritet të nisë ndërhyrja për rijetëzimin e konakëve, ndërsa në Lekël të Tepelenës vijojnë punimet për restaurimin e Kishës së Profetit Ilias, të dëmtuar nga zjarret. Këto ndërhyrje synojnë të forcojnë lidhjen mes turizmit dhe trashëgimisë kulturore, duke krijuar destinacione më tërheqëse dhe duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm lokal.

RIHAPET MUZEU ARKEOLOGJIK I DURRËSIT ME STANDARDE TË REJA DHE EKSPOZITË TËRËSISHT TË RIKONCEPTUAR

Muzeu Arkeologjik i Durrësit u rihap për publikun pas një transformimi të plotë, duke shënuar një moment të rëndësishëm për trashëgiminë kulturore dhe qytetin. I restauruar tërësisht dhe me një linjë të re muzeale, muzeu ofron kushte të



përmirësuar dhe një ekspozitë të rikonceptuar, ku mbi 3200 artefakte rrëfejnë historinë në mënyrë bashkëkohore, me theks të veçantë të “Bukuroshja e Durrësit”, tashmë e rikthyer në vendin e saj. Projekti, i realizuar në bashkëpunim me Bashkimin Europian përmes programit EU4Culture dhe zbatuar nga UNOPS, përfaqëson një investim të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor. Muzeu hap dyert me hyrje të lirë për 15 ditët e para, duke ftuar publikun të përjetojë këtë hapësirë të re të kujtesës dhe dijes.

FIP PLATINUM ALBANIA 2026: TIRANA NË HARTËN NDËRKOMBËTARE TË SPORTIT DHE TURIZMIT



Gjatë konferencës për shtyp të Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, me Presidentin e Federatës Ndërkombëtare të Padelit, Luigi Carraro, u prezantua Kampionati “FIP Platinum Albania 2026” si një moment i rëndësishëm për zhvillimin e sportit dhe promovimin ndërkombëtar të Shqipërisë. Ky event, që do të zhvillohet në Tiranë në Sheshin Skënderbej më 26–30 maj, pritet të sjellë sportistë elitare, trajnerë dhe ekspertë nga e gjithë bota, duke dëshmuar kapacitetet organizative të vendit dhe angazhimin për të qenë pjesë aktive e kalendarit global të sporteve moderne. Përvoja ndërkombëtare tregon se aktivitete të tilla

nxisin fluksin e vizitorëve dhe ndikojnë drejtpërdrejt në sektorë si akomodimi, transporti dhe shërbimet, duke kontribuar në zhvillimin e turizmit sportiv dhe ekonomisë lokale.

TAKIME ME OPERATORËT TURISTIKË NË GOLEM DHE VLORË: FOKUS TE STANDARDET, INFRASTRUKTURA DHE ZGJATJA E SEZONIT TURISTIK



Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Goxhja, zhvilloi disa takime me operatorët turistikë në Golem, Vlorë dhe Sarandë, ku në fokus ishte zhvillimi i mëtejshëm i sektorit përmes rritjes së standardeve, përmirësimit të infrastrukturës dhe zgjatjes së sezonit turistik. Diskutimet u përqendruan te diversifikimi i ofertës turistike, menaxhimi më i mirë i plazheve publike, përmirësimi i transportit urban dhe shërbimeve bazë, si dhe investimet strategjike në portet turistike dhe turizmin detar. Përmes koordinimit institucional dhe bashkëpunimit me operatorët, synohet zhvillimi i një turizmi më cilësor, të qëndrueshëm dhe konkurrues për ekonominë lokale dhe turizmin shqiptar.



“SAMITI I IV I DIASPORËS SHQIPTARE” SI URË LIDHËSE MES IDENTITETIT, KULTURËS DHE ZHVILLIMIT

Në fillim të muajit, “Samiti i IV i Diasporës Shqiptare” solli në qendër rolin e diasporës në ruajtjen dhe promovimin e identitetit shqiptar në botë, duke shërbyer si një platformë e rëndësishme dialogu dhe bashkëpunimi. Përgjatë dy ditëve, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit organizoi dhe mori pjesë në panele mbi kulturën, trashëgiminë, turizmin dhe sportin, duke theksuar rëndësinë e diplomacisë kulturore, rrjeteve të qendrave kulturore shqiptare dhe rolit të diasporës në promovimin ndërkombëtar të Shqipërisë. Aktivitetet kulturore dhe performancat artistike pasuruan atmosferën e samitit, ndërsa u riafirmua angazhimi për një bashkëpunim më të strukturuar dhe afatgjatë me diasporën si partner kyç në zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR MUZEUN “BESA” NË TIRANË, NJË PROJEKT ME RËNDËSI HISTORIKE DHE KULTURORE

U nënshkrua marrëveshja mes Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Fondacionit kulturor Besa për jetëzimin e Muzeut “Besa” në Tiranë, një projekt që synon të sjellë në vëmendje një nga kapitujt më domethënës të historisë dhe identitetit shqiptar. Përmes një qasjeje të specializuar muzealizimi dhe interpretimi, muzeu do të rrëfejë historitë e familjeve shqiptare që gjatë Luftës së Dytë Botërore strehuan dhe shpëtuan hebrenjtë, duke mishëruar vlerat e besnikërisë, mikpritjes dhe nderit. Projekti, i cili pritet të realizohet brenda 36 muajve dhe do të financohet përmes donacioneve dhe filantropisë, përbën një hap të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit historik dhe kulturor, duke synuar të krijojë një hapësirë të veçantë reflektimi dhe kujtese në zemër të Tiranës.



DELVINA FITON STATUSIN “ANSAMBËL ARKITEKTONIK URBAN”, HAP I RËNDËSISHËM PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Qyteti i Delvinës u shpall “pasuri kulturore e paluajtshme” me statusin Ansambël Arkitektonik Urban, duke shënuar një zhvillim të rëndësishëm për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Ky vendim krijon një kornizë të plotë ligjore për ruajtjen e vlerave arkitektonike, urbanistike dhe historike, duke i hapur rrugë restaurimit dhe rijetëzimit të objekteve dhe hapësirave karakteristike. Në fokus janë banesat tradicionale me elementë dekorativë në gur e dru, çatitë me tjegulla vendi dhe rrjeti i rrugëve me kalldrëm, që përbëjnë identitetin unik të qytetit. Në vijim, përmes bashkëpunimit institucional, priten investime infrastrukturore dhe programe promovimi, duke e kthyer Delvinën në një destinacion më tërheqës turistik dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik lokal.



ZGJEROHET PROGRAMI I RIJETËZIMIT TË KULLAVE ME BASHKËPUNIM NDËRINSTITUCIONAL PËR ÇËSHTJET E PRONËSISË



Në Kullën e Çun Mules në Malësi të Madhe, u firmos marrëveshja ndërinstitucionale mes Minsitrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, GIZ dhe Agjencisë Shtetërore të Kadasrës, duke shënuar një hap të rëndësishëm në konsolidimin e Programit të Rijetëzimit të Kullave. Bashkëpunimi synon adresimin e strukturuar të çështjeve të pronësisë si kusht kyç për realizimin e investimeve, ndërkohë që po ndërtohet një qasje e integruar me përfshirjen edhe të Fakultetit të Arkitekturës. Paralelisht, puna në terren ka nisur, ku janë mbështetur të gjithë aplikantët, 4 janë

pajisur me certifikatë pronësie dhe 28 janë në proces, me një pjesë të konsiderueshme që kanë përfunduar matjet në terren. Këto zhvillime përbëjnë një progres të rëndësishëm drejt krijimit të një baze të qëndrueshme ligjore dhe institucionale, në funksion të zhvillimit ekonomik lokal, nxitjes së investimeve dhe rritjes së turizmit kulturor.

MAT: INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN KULTURORE DHE FUQIZIM I JETËS ARTISTIKE E RINORE

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit prezantoi në Mat një sërë investimesh të rëndësishme në infrastrukturën kulturore dhe hapësirat publike, duke sjellë transformime konkrete në shërbim të komunitetit dhe jetës artistike. Në Pallatin e Kulturës “Shefqet Doda”, tashmë i rikonstruktuar tërësisht me kushte moderne dhe funksionale, u nënshkrua edhe marrëveshja për rijetëzimin e hapësirave kinematografike publike, me fokus zhvillimin e programeve artistike dhe edukative për qytetarët. Paralelisht, Galeria e Arteve “Tahir Tahiraj” dhe Biblioteka “Pjetër Budi” janë trans



formuar në hapësira bashkëkohore që risin aksesin dhe cilësinë e shërbimeve kulturore. Në qendër të angazhimit institucional ishte edhe mbështetja për të rinjtë, përmes politikave dhe programeve që synojnë forcimin e rolit të kulturës dhe rinisë në jetën komunitare dhe në perspektivën europiane të vendit.

“KTHE PASIONIN NË PROFESION”, INDUSTRIA KREATIVE NË FOKUS TË ZHVILLIMIT DHE PUNËSIMIT



“Kthe Pasionin në Profesion”, i organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë, solli së bashku të rinj, profesionistë dhe institucione për të krijuar mundësi konkrete zhvillimi dhe punësimi në industrinë kreative, një sektor që kontribuon rreth 3% të PBB-së dhe punëson mbi 21,000 persona. Aktiviteti përfshiu trajnime praktike, masterclass, panele diskutimi dhe prezantime projektësh, duke forcuar lidhjen mes edukimit dhe tregut të punës. Paralelisht, sektori kulturor vijon të shënojë rritje të ndjeshme, ku gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, 92,918 vizitorë vendas dhe të huaj frekuentuan institucionet dhe qendrat kulturore, një rritje prej 81% krahasuar me vitin 2023, me një interes të lartë për parqet arkeologjike, kalatë, muzetë dhe monumentet kryesore të vendit.



RRITET NDJESHËM INTERESI PËR INSTITUCIONET DHE SITET KULTURORE NË SHQIPËRI

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, institucionet dhe qendrat kulturore në vend u vizituan nga 92,918 vizitorë vendas dhe të huaj, duke shënuar një rritje prej 81% krahasuar me vitin 2023. Nga totali i vizitorëve, 39,338 frekuentuan muzetë kombëtarë, ndërsa 53,580 vizituan parqet arkeologjike, kalatë dhe monumentet e kulturës, duke reflektuar interesin në rritje për trashëgiminë kulturore të Shqipërisë. Ndër sitet më të vizituara spikasin Parku Arkeologjik i Kalasë së Shkodrës, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Krujë, Kalaja e Gjirokastrës, Parku Kombëtar i Butrintit dhe Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”, duke konfirmuar rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të turizmit kulturor në zhvillimin e sektorit.

BULQIZË DHE DIBËR: RESTAURIM I TRASHËGIMISË KULTURORE DHE ZHVILLIMI I DESTINACIONEVE TË REJA TURISTIKE

Në Bulqizë dhe Dibër po vijojnë ndërhyrjet për mbrojtjen dhe rijetëzimin e trashëgimisë kulturore, të lidhura ngushtë me zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë lokale. Në Zerqan, një banesë tradicionale Monument Kulture i kategorisë së parë, pjesë e një kompleksi rural me vlera të rralla arkitekturore, po restaurohet nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, duke ruajtur autenticitetin dhe duke synuar shndërrimin e saj në muze familjar dhe hapësirë për vizitorët. Paralelisht, në Bulqizë po zhvillohet projekti inovator “Parku Retro”, një hapësirë e re turistike dhe komunitare që do të rikthejë në funksion asete publike të degraduara, ndërsa në Peshkopi, Xhamia e Allajbegisë është restauruar duke ruajtur vlerat e saj historike dhe shpirtërore. Këto investime përfaqësojnë një qasje të integruar që lidh ruajtjen e identitetit kulturor me zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimin e destinacioneve të reja turistike në rajon.




“OJNAT” DREJT UNESCO-S SI TRASHËGIMI E GJALLË QË PËRFAQËSON SHQIPËRINË NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

Në fillim të muajit, “Ojnat”, arti i rafinuar i thurjes me grep dhe gjilpërë në traditën shqiptare, u nominuan në një dosje të përbashkët me Rumaninë dhe Turqinë për përfshirje në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit në UNESCO.

Kjo trashëgimi e çmuar, e ruajtur dhe përcjellë ndër breza nga gratë shqiptare, vijon të jetojë përmes mjeshtërisë së artizaneve, duke ndërthurur traditën me frymën bashkëkohore.

Nominimi përfaqëson një hap të rëndësishëm në promovimin ndërkombëtar të kulturës shqiptare dhe në mbrojtjen e saj si një pasuri e gjallë e identitetit kombëtar.



NDËRHJRJE TË REJA NË PARKUN KOMBËTAR TË BUTRINTIT PËR SIGURINË DHE PËRMIRËSIMIN E EKSPERIENCËS SË VIZITORËVE

Në fillim të muajit, në Parkun Kombëtar të Butrintit po vijnë ndërhyrjet për rritjen e sigurisë dhe përmirësimin e cilësisë së vizitës në një prej siteve më të rëndësishme të trashëgimisë botërore nën UNESCO. Nën administrimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, kanë nisur punimet për vendosjen e parrakëve mbrojtës në zonën e teatrit antik dhe në disa prej shtigjeve kryesore të parkut, ndërsa sistemi i monitorimit 24/7 me kamera po forcon standardet e administrimit dhe mirëmbajtjes së sitit. Paralelisht, po avancojnë projektet për ndërtimin e qendrës së re të vizitorëve, parkimit publik dhe përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse, përfshirë ndriçimin, transportin dhe shërbimet për turistët. Këto investime synojnë të rrisin sigurinë, aksesin dhe cilësinë e eksperiencës për mbi 300 mijë vizitorët që frekuentojnë çdo vit Parkun Kombëtar të Butrintit, duke forcuar më tej profilin e tij si një destinacion kulturor dhe turistik i rëndësishëm në rajon.

DORËZOHET PLANI STRATEGJIK PËR GALERINË E RE KOMBËTARE TË ARTEVE NË BASHKËPUNIM ME MAXXI

U mbajt takimi për dorëzimin zyrtar të raportit të Planit Strategjik për Galerinë e re Kombëtare të Arteve, hartuar nga MAXXI – Museo Nazionale delle Arti del XXI secolo, në kuadër të bashkëpunimit Shqipëri-Itali përmes marrëveshjes G2G. Dokumenti paraqet një vizion bashkëkohor për administrimin dhe zhvillimin e institucionit, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve profesionale, mbështetjen institucionale, realizimin e projekteve të përbashkëta dhe përafrimin me standardet më të mira evropiane. Marrëveshja katërvjeçare vendos themelet për një partneritet afatgjatë në funksion të modernizimit të institucioneve kulturore, edukimit artistik dhe pasurimit të jetës kulturore në vend.

